

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-703 W

IMPREGNIM I PADEPËRTUESHËM NGA UJI PËR FASADAT E NDËRTESAVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-703 W është një emulsion impregnimi, gati për përdorim, kombinim me bazë silani / siloksani dhe i padepërtueshëm nga uji.

PËRDORIMET

Për të bërë fasadat të padepërtueshme nga uji dhe për mbrojtjen e ndërtesave kundër hyrjes së ujit. Sikagard®-703 W mund të aplikohet në llaç, mure, tulla, gur, asbest, çimento etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kapacitet i fuqishëm kundër depërtimit të ujit.
- Lejon transpirimin e nënshtresës (i përshkueshëm nga avujt).
- Trajtimi është zakonisht i padukshëm dhe nuk ndryshon pamjen e nënshtresës.

- Për shkak të reduktimit të absorbueshmërisë së ujit, përmirëson rezistencën e fasadave nga njollosja dhe mbledhja e pislëqeve dhe ndihmon në reduktimin e rritjes së myshqeve dhe likeneve.
- Mund të mbivishet me bojëra dhe veshje të përshtatshme.
- Gati për përdorim.
- Me bazë uji dhe miqësor ndaj mjedisit.

MIRATIME / STANDARDE

- PV Véritas Nr. 1108203/2A & 2B, vjetrimi, përshkueshmëria e avujve të ujit, absorbueshmëria e ujit.
- Instituti Belg për Kërkime rreth Ndërtimit - Përcaktimi i rezistencës kundër avujve të ujit dhe koeficientit të absorbueshmërisë së ujit të një produkti të lëngshëm hidrofobik të aplikuar mbi një mur argjili. Raport Nr DE 621X8570, LMA 5631, data 16/12/2014

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Kombinim silani / siloksani
Ambalazhi	kanaçe 2 dhe 5 l, kovë 20 l
Paraqitja / Ngjyra	lëng i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar.
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në kushte të thata dhe të freskëta. Të mbrohet nga lagështia.
Dendësia	~ 1.0 kg/l (në +20 °C)

TË DHËNA TEKNIKE

Përshkueshmëria e avujve të ujit	Nënshtresa	Nënshtresa me Sikagard®-703 W	Vetëm Sikagard®-703 W	(EN ISO 12572)
Trashësi ekuivalente ajri - S _d (m)	0.36	0.36	0.003	

Absorbueshmëria kapilare	Nënshtresa	Nënshtresa me Sikagard®-703 W	(EN ISO 15148)
Koeficienti i absorbueshmërisë së ujit pas 24 orësh Aw, 24 [kg/m ² s ^{0.5}]	0.046	0.021	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Në varësi të porozitetit të nënshtresës: Mbi llaç: ~ 150–200 g/m ² Mbi materiale të tjera poroze: ~ 300–500 g/m ² (Nevojitet një test për të përcaktuar konsumimin e saktë).
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +35 °C max.
Koha e pritjes / mbiveshja	Mund të vishet me bojra polimeri me bazë uji dhe tretësi - kontaktoni me prodhuesin e bojës për detaje. Për mbiveshje me Sikagard®, SikaColor® Emulsion ose veshje me bazë tretësi, prisni të paktën 5 orë pas impregnimit hidrofobik.
Metoda e maturimit	Sikagard®-703 W nuk kërkon asnjë trajtim të veçantë, por duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 3 orë në +20°C.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

E pastër, e qëndrueshme, pa ndryshk, pislleqe, vaj dhe graso, e floreshencë dhe veshje të tjera të boje, etj. Plasaritjet më shumë se 300 µm duhet të riparohen përpara kryerjes së trajtimit hidrofobik.

Pastrimi duhet bërë me anë të detergjentëve të përshtatshëm ose me avull të lehtë ose pastrim me fryrje.

Përftohen rezultate më të mira mbi nënshtresa të thata, shumë absorbuese.

Nënshtresa duhet të ketë pamje të thatë, pa pjesë të lagështa.

APLIKIMI

Sikagard®-703 W aplikohet me spërkatës konvencional në presion të ulët, furçë ose rul, në kalime të ndryshme, i lagësht mbi të lagësht, nga poshtë lartë duke u kujdesur për të mos lënë produktin të rrjedhë derisa të arrihet ngopja e nënshtresës.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë të pastër menjëherë pas përdorimit.

Materiali i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nënshtresat me bazë çimentoje duhet të kenë moshë të paktën shtatë ditë.
- Mbroni sipërfaqet e xhamit dhe kornizat e aluminit (mundësi dëmtimi të sipërfaqes / njollosje).
- Përpara përdorimit, testoni mbi një mostër sipërfaqeje.
- Nuk mund të mbivishet me gëlqere ose veshje çimentoje.
- Mbi të gjitha nënshtresat, aftësia optimale kundër depërtimit të ujit arrihet pas pak ditësh.
- Aftësia për padepërtueshmëri ndaj ujit, reduktohet ndjeshëm kur nënshtresa është plasaritur.
- Referohuni tek method statement për procedurën e aplikimit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard®-703 W

Mars 2019, Botimi 01.01

020405030030000034

Sikagard-703W-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf